

URDHËR
Nr. 152, datë 17.7.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 6. të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe vendimit nr. 496, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të dhëna në konkurrim”,

URDHËROJ:

Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Enkelejda Muçaj, për drejtimin e Komisionit *ad hoc* për Negociimin e Rinovimit të Autorizimit Individual të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike Vodafone Albania sh.a. dhe drejtimin e procesit negociues të rinovimit të autorizimit individual të sipërmarrësit të komunikimeve elektronike Vodafone Albania sh.a. për përdorimin e spektrit të frekuencave prej 4 MHz i çiftuar, në brezin 900 MHz dhe 9 MHz i çiftuar në brezin 1800 MHz, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 496, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të rinovimit të autorizimit individual për përdorimin e frekuencave të dhëna në konkurrim”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku